



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës
Kuvendi i Komunës së Junikut
Numër: 002/10
Datë: 19.03.2026

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FRESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut
Nga: Leonard Ljolluni – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut
Lënda: Mbledhja e tretë - (2026) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut
Data: 31.03.2026, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për barjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshimeve në rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Kuvendit të Junikut për vitin 2025,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i iniciimit të procedurave për hartimin e planit tre-vjeçar për strehim social,
6. Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i iniciimit të procedurës për hartimin e "Planit për menaxhimin e Tokave Rurale 2026-2030,
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit,
9. Të ndryshme.



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

D1/Nr. Prot. 2-155/166A
Nje. Org 2
Nr. ifaq. 1
Data 09/03/2026



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	09.03.2026
PËR/ZA/TO:	Lëonard Lolluni – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Ardita Hoxha - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 13, neni 58 dhe Statutit të Komunës së Junikut me Nr. 001/3127 të datës 29.09.2010 neni 43 dhe Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal kërkojmë që të bëhet bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026.

Në vitin 2025 janë planifikuar të inkasohen të hyra vetanake në vlerë prej 204,942.00€, ndërsa shuma e inkasuar për vitin 2025 duke përfshirë edhe të hyrat nga gjambat në trafik është 166,489.60 €. Të hyrat e bartura nga viti 2024 në vitin 2025 janë në vlerë prej 108,484.86 €, ku gjithsej të hyra në vitin 2025 duke i përfshirë edhe të hyrat e bartura janë 274,974.46€. Nga kjo shumë e të hyrave vetanake gjatë vitit 2025 janë shpenzuar gjithsej 224,554.50€.

Shuma e mbetur për bartje është 50,419.96 € ku kërkojmë që bartja të bëhet në këto Program dhe kategori ekonomike si vijon:


Kategoria e investimeve kapitale 30,419.96€

- Shuma prej 28,419.96 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 46030 "Bashkëfinancimi i projekteve", në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020.
- Shuma prej 2,000.00 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 56323 "Rekonstruimi i rrugës "Shkëlzen Gacaferi" Faza I", në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020 – Projekt i mbetur obligim nga viti 2025.

Kategoria e Shpenzimeve komunale 20,000.00€

- Shuma prej 20,000.00 € të bartet në kategorinë ekonomike Shpenzime Komunale, në Programin Shërbime publike me kod 180, në nën programin Infrastruktura rrugore me kod 18020.

Në total të hyra për bartje nga viti 2025 në vitin 2026 janë 50,419.96 €



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Datë/a:	17.03.2026
Referencë/a:	Nr. V-3/26
Për/To/Za :	z. Leonard Lolluni – Kryesues i Kuvendit Komunal
Përmes/ Throught/ Preko	z. Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës së Junikut
CC :	z. Besart Tofaj – Nënkryetar i Komunës së Junikut
Nga/From/Od:	z. Tafë Tofaj – U.D Shef për Ekonomi dhe Zhvillim
Tema/Subject/Subjekat:	Kërkesë



I nderuar,

Bazuar në raportin e dërguar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për periudhën janar – dhjetor 2025, për Zyrën për Integritet Evropian të Komunës së Junikut, është dhënë rekomandim ndaj Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim që të bëjë hartimin e Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale.


Andaj, ju lutem që të na mundësoni inicimin e procedurave për hartimin e “Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale 2026 – 2030”.

Me respekt!



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

01/Nr. Prot. 2-155/1842
Një. Org. 2
Nr. i faq. 1
Gata 17/03/2026



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Referencë/Reference:	Nr. 8-1/26
PËR/ZA/TO:	z. Leonard Lolluni - Kryesues në Kuvendin Komunal - Junik
CC.	Anëtarët e Kuvendit Komunal në Junik
PËRMES	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës - Junik
NGA/OD/FROM:	z. Fatos Shala Drejtor për SHMS-së - Komuna Junik
DATË/A:	17.03.2026
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	1. Kërkesë për të vendosur në rendë të ditës inicimin e procedurave per Hartimin e Planit tre vjeçar për strehim social

Te nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme që kemi dhe duke qenë të vendosur që të kemi bashkëpunim edhe më tutje.

Drejtoria për SHMS-së kërkon nga ana e juaj që të kemi në rendë të ditës në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal kërkesën për të vendosur në rendë të ditës inicimin e procedurave per Hartimin e Planit tre vjeçar për strehim social.

Shpresojmë që kërkesa jone do të gjejë mirëkuptim nga ana juaj!

Ju falënderojmë për bashkëpunim!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim

DATE/A:	11.03.2026
PËR/ZA/TO:	z. Leonard Llolluni – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Demokrat Ganiçaj – Drejtor për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimet për ndryshime



I nderuar,

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale, kërkojmë që të futet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe atë të Kuvendit Komunal, propozimet për ndryshime në Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave.

Bazuar në Vendimin Nr.01/32 të datës 12.02.2026 të Kryetarit të Komunës, si dhe në kompetencat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 02/L-030 për Mbeturina dhe në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale, ju paraqesim propozimet për ndryshime në Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave.

Ndryshimi i Rregullore lidhet kryesisht me ndryshimin e tarifave për shërbimet e ofruara, ku në nenin 23 të Rregullore aktuale janë të kategorizuar konsumatorët si dhe janë të përcaktuara tarifat, pra ndryshimet ndërlidhen me nenin 23 të Rregullore aktuale .

Tarifat ekzistuese janë:

TARIFA PËR GRUMBULLIM, TRANSPORTIM DHE DEPONIM TË MBETURINAVE

- 1- Kategoritë e konsumatorëve do të paguajnë faturë mujore për shërbimin e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave si në vijim:
 - a. **Kategoria e konsumatorëve shtëpiak – amvisëritë:** Nënkatëgoria e parë dhe Nënkatëgoria e dytë konsumatorët (banorët resident) do të paguajnë tarifë fikse 6.00 € (me TVSH) në muaj.
Nënkatëgoria e tretë, konsumatorët (banorët jo resident) do të paguajnë tarifën fikse në vlerë prej 2.00 Euro (me TVSH) në muaj.
 - b. **Kategoria e konsumatorëve Komercial / Industrial.**
 1. **Nënkatëgoria e parë:** veprimtarit e vogla zejtarë dhe shërbyese do të paguajnë tarifë fikse prej 6.00 Euro (me TVSH) në muaj.
 2. **Nënkatëgoria e dytë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industriale me kosto të ulët të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 11.00 Euro (me TVSH) në muaj.
 3. **Nënkatëgoria e tretë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industriale me kosto të moderuar të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 17.20 Euro (me TVSH) në muaj.
 4. **Nënkatëgoria e katërt:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industriale me kosto të lartë të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 26.00 Euro (me TVSH) në muaj. Në këtë kategori kemi edhe biznese të mëdha me kontrata të veçanta fikse.
 5. **Nënkatëgoria e pestë:** subjektet komerciale / industriale të shërbyer me kontrata të veçanta, konkretisht me kontejnerë 1.1 m³ dhe 7m³ do të paguajnë tarifë prej 14.00 Euro (me TVSH), për një zbrazje për kontejnerë 1.1m³ dhe 45.00 Euro (me TVSH) për një zbrazje për kontejnerë 7m³
 6. **Kategoria e konsumatorëve institucional:** Të shërbyer me kontrata të veçanta, konkretisht me kontejnerë 1.1 m³ do të paguajnë tarifë prej 14.00 Euro (me TVSH) për një zbrazje dhe 45.00 Euro (me TVSH) për një zbrazje për kontejnerë 7m³.

Tarifat e propozuara

Kategoritë e konsumatorëve do të paguajnë laturë mujore për shërbimin e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave si në vijim:

c. **Kategoria e konsumatorëve shtëpiak – amvisëritë:** Nënkatëgoria e parë dhe Nënkatëgoria e dytë konsumatorët (banorët resident) do të paguajnë tarifë fikse 7.00 € (me TVSH) në muaj.

Nënkatëgoria e tretë, konsumatorët (banorët jo resident) do të paguajnë tarifën fikse në vlerë prej 2.50 Euro (me TVSH) në muaj.

d. **Kategoria e konsumatorëve Komercial / Industrial.**

7. **Nënkatëgoria e parë:** veprimtarit e vogla zejtare dhe shërbyese do të paguajnë tarifë fikse prej 7.00 Euro (me TVSH) në muaj.

8. **Nënkatëgoria e dytë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industriale me kosto të ulët të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 12.50 Euro (me TVSH) në muaj.

9. **Nënkatëgoria e tretë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industriale me kosto të moderuar të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 19.50 Euro (me TVSH) në muaj.

10. **Nënkatëgoria e katërt:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industriale me kosto të lartë të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 29.00 Euro (me TVSH) në muaj. Në këtë kategori kemi edhe biznese të mëdha me kontrata të veçanta fikse.

11. **Nënkatëgoria e pestë:** subjektet komerciale / industriale të shërbyer me kontrata të veçanta, konkretisht me kontejnerë 1.1 m³ dhe 7m³ do të paguajnë tarifë prej 16.00 Euro (me TVSH), për një zbrazje për kontejnerë 1.1m³ dhe 50.00 Euro (me TVSH) për një zbrazje për kontejnerë 7m³

12. **Kategoria e konsumatorëve institucional:** Të shërbyer me kontrata të veçanta, konkretisht me kontejnerë 1.1 m³ do të paguajnë tarifë prej 16.00 Euro (me TVSH) për një zbrazje dhe 50.00 Euro (me TVSH) për një zbrazje për kontejnerë 7m³.

Në vazhdim do të paraqiten në mënyrë tabelare kategoritë e konsumatorëve dhe propozimet për ndryshime të tarifave.

Nr.	Kategoria e konsumatorëve	Tarifa aktuale për muaj me TVSH	Tarifa e propozuar për muaj me TVSH
1.	Kategoria e konsumatorëve shtëpiak – amvisëritë		
1.1.	Nënkategoria e parë dhe Nënkategoria e dytë konsumatorët (banorët resident)	6.00€	7.00€
1.2.	Nënkategoria e tretë, konsumatorët (banorët jo resident)	2.00€	2.50€
2.	Kategoria e konsumatorëve Komercial / Industrial.		
2.1.	Nënkategoria e parë	6.00€	7.00€
2.2.	Nënkategoria e dytë	11.00€	12.50€
2.3.	Nënkategoria e tretë	17.20€	19.50€
2.4.	Nënkategoria e katërt	26.00€	29.00€
2.5.	Nënkategoria e pestë		
2.5.1.	Kontejnerët 1.1. m ³	14.00€	16.00€
2.5.2.	Kontejnerët 7 m ³	45.00€	50.00€
2.6.	Kategoria e konsumatorëve institucional		
2.6.1.	Kontejnerët 1.1. m ³	14.00€	16.00€
2.6.2.	Kontejnerët 7 m ³	45.00€	50.00€

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

Ministria e Ekonomisë, në mbështetje të neneve 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina, nenit 11 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 8 paragrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

1. Caktohet tarifa e deponimit të mbeturinave komunale në deponitë e menaxhuara nga Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) ShA në lartësi prej shtatë euro e tridhjetë e një centë (7,31) për ton, e zbatueshme nga 1 janari 2023.
2. Tarifa nga pika 1 e këtij vendimi rritet për një (1) euro më 1 janar të secilit vit pasues, duke përfshirë vitin 2027, dhe mund të rishikohet sipas nevojës për të siguruar qëndrueshmërinë financiare, operative dhe mjedisore të KMDK-së.
3. Obligohet KMDK të zbatojë këtë vendim.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

KMDK, ndërmarrje publike, menaxhon katër deponi sanitare dhe një stacion transferi të mbeturinave komunale. Tarifa e deritanishme 5,31 euro për deponimin e një toni të mbeturinave ka qenë e panjafitueshme për të siguruar qëndrueshmërinë financiare, operative dhe mjedisore të KMDK-së. Rritja e tarifës, si në dispozitiv, bëhet në marrëveshje me komunat përkatëse.



- U dërgohet:
- MMPHI
 - Kabinetit të Ministres
 - Të gjitha komunave
 - Sekretarit të Përgjithshëm të ME-së
 - KMDK ShA
 - NjPMNP
 - Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	18.03.2026
PËR/ZA/TO:	z. Leonard Llolluni – Kryesues i Kuvendit Komunal
CC:	z. Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës së Junikut
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Besart Tofaj – Nënkryetar i Komunës së Junikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë



I nderuar,

Duke u bazuar në Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht në kompetencat e komunës për ofrimin e sigurisë publike dhe mirëqenies së qytetarëve, si dhe në Udhëzimi Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, i cili përcakton përbërjen, themelimin dhe funksionimin e tyre, kërkojmë nga Kuvendi Komunal i Komunës së Junikut themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Përbërja e propozuar e KKSB-së është si vijon:

1. **Ruzhdi Shehu** – Kryetar i Komunës (Kryesues)
2. **Rasim Sylja** – Komandant i Stacionit Policor në Junik
3. **Imer Krasniqi** – Përfaqësues i Bashkësisë Islame
4. **Driton Sylja** – Përfaqësues i komunitetit Halveti
5. _____ – Kryesuesi i Komitetit për Komunitete
6. **Liberta Hoxha** – Zyrtare për Barazi Gjinore
7. **Xhavit Velijaj** – Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
8. **Florant Pepshi** – Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut
9. **Vedat Shatri** – Përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës
10. **Blerina Sallaj** – Përfaqësuese e Këshillit Lokal për Siguri Publike
11. **Guxim Gjocaj** – Përfaqësues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi
12. **Shkelzen Shehu** – Përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile
13. **Zeqë Shehu** – Përfaqësues nga OJQ
14. **Leonita Jasiqi** – Përfaqësuese e Zyrës për Komunitete dhe Kthim
15. **Alban Miroci** – Përfaqësues i mediave lokale
16. **Haki Jasiqi** – Përfaqësues i komunitetit të biznesit
17. **Qamil Jasiqi** – Përfaqësues i personave me aftësi të kufizuara

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK
 OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër 02-02/26
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Leonard L.olluni - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	27.02.2026
TEMA/SUBJFKA I/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së dytë (2), të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 27.02.2026, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Leonard L.olluni, i cili në fillim përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, më pas e konstatoi se prezent në sallën e kuvendit janë 14 antarët e Kuvendit e Komunës së Junikut.

Anëtarët prezent

1. Leonard L.olluni-Kryesues, AAK
2. Bedrush Hoxha-anëtar, LDK
3. Litaferi Tsufa-anëtar, LDK
4. Shpejtim Gacaferi- anëtar, LDK
5. Sadri Krasniqi- anëtar, LDK
6. Floris Miroci-anëtar, LDK
7. Blerta Sylja-anëtar, LDK
8. Burim Kuçi-anëtar, AAK
9. Ajshe Gacaferi-anëtare, AAK
10. Aldi Gacaferi-anëtar, AAK
11. Arlinda Pepshi-anëtare, AAK
12. Alfred Gaxherri-anëtar, AAK
13. Jetmir Tofaj-anëtar, LVV
14. Elsa Hima-anëtare, LVV
15. Lulzim Gacaferi-anëtar, LVV -Mungon

Rendi i ditës i paraparë

1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për Hartimin e planit Lokal për Veprim në mjedis,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e "Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2033",
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Inicimit të procedurave për hartimin e Planeve Strategjike të Komunës së Junikut, të cilat janë në kompetencë të Drejtoris për Shërbime Publike, Inspektim, Mbrojtje dhe Shpëtim:
 - Plani i Vlerësimit të Rrezikut,
 - Plani për Reagim Emergjent,
 - Plani i Transportit Publik dhe Mobilitetit,
 - Plani për Mirëmbajtjen e Rrugëve dhe Hapësirave Publike,
 - Plani për Mirëmbajtjen e Rrjetit të Ujësjellësit dhe Kanalizimit,
 - Plani Komunal për Menaxhim të Mbrojturave,
 - Plani Komunal për Menaxhimin dhe kontrollin e Qenve me dhe pa pronar.
5. Themelimi i Komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e këshillit lokal, si dhe komisioni i ankësave lidhur me procesin e zgjedhjeve të këshillave Lokale,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut 2026-2030,
7. Themelimi i Komiteti për Arsim, Shkencë, Kultur, Rinë dhe Sport,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurës për ndryshim të Rregullores për taksë, ngarkesa dhe gjoha komunale,
9. Harmonizimi i vendimit me nr:002/05 date 02.02.2026 të listese së pergjishme të pronave në posedim të Komunes si dhe listese e veqante të planifikuara për dhenje në shfrytëzim,
10. Propozim për Lijim të Mjeteve Finaciare për Kompenzimin e Anëtarëve të Komiteteve tjera të Komunës së Junikut
11. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit dhe
12. Të ndryshme

z.Leonard Llojuni, para se të kalojmë rendin e ditës , kemi një kerkese nga Drejtoria për Kadaster, urbanizëm dhe Mjedis që si pike të nente (9) e rendit të ditës të hynë Harmonizimi i vendimit me nr:002/05 date 02.02.2026 të listese së pergjishme të pronave në posedim të Komunes si dhe listese e veqante të planifikuara për dhenje në shfrytëzim, kjo pike duhet të shtohet për rend të ditës sepse vendimi 002/05 nuk e ka kaluar ligjshmërinë, nga MAPL.

z.Jetmir Tofaj, përshëndetje për të gjithë, nëse më lejohet unë kam një pike shtese të rendit të ditës që të shtohet për shqyrtim sote e ajo është, propozim për lijim të mjeteve finaciare për kompenzimin e anëtarëve të komiteteve tjera të komunës së Junikut.

z. Shpejtim Gacafëri, përshëndetje për të gjithë, pasi që jemi të redi i ditës në si grupe kemi vrejtje të pikave katër (4) e rendit të ditës, jemi dakort që kjo të kalojë por mos të na kalojë në shprehje, janë një mori pikash në kuadër të kësaj pike, kryesuesi në bashkëpunim me anëtarët e kuvendit kanë të drejtë që të bashkohen disa pika nëse ato pika janë vetëm për shqyrtim, ndërsa këto janë edhe për miratim, po ashtu edhe për pikën shtatë (7) duhet të hiqet nga rendi i ditës, nuk me takon të zgjerohem me shumë tek kjo pikë por propozimi i grupit të LDK-së është që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës.

z. Jetmir Tofaj, vetëm sa për plotësim të emrit të pikës së shtatë (7) për komitetin për arsim shkencë kulturë rinë dhe sport vetëm sa për procesverbal.

z. Leonard Llojuni, sa i përket pikës së katër (S) kërkesa na ka ardhur si titull nga drejtorja, është vetëm inicim i procedurave për më shumë mund të na sqaroi incuesi i kësaj kerkese UD- drejtori i shërbimeve publike z. Demokrat Ganiçaj.

z. Demokrat Ganiçaj, përshëndetje për të gjithë, në kemi bërë kerkese të zyra e Kryetarit që të fillojmë me inicimin e procedurave për këto plane sepse planeve aktuale veq se kanë skaduar dhe në mënyrë që mos të vijnë veq e veq me një palë kemi bërë kerkese për të gjitha planet, nëse kjo nuk parashihet në rregullorë të punës së kuvendit atëherë të hiqet dhe në të ardhmen bëjmë kerkese për secilin plan veq e veq.

z. Burim Kuçi, përshëndetje për të gjithë, unë pajtohem me kërkesën e z. Jetmir Tofaj që si pikë e rendit të ditës të hyjë kërkesa e tij për kompenzimin e antarëve të komiteteve të tjera.

z. Leonard Llojuni, e hudhi në votim rendin e ditës me këto dy kërkesa, kush është për, për 14 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i ditës u miratua.

z. Ruzhdi Shehu, përshëndetje për të gjithë, qeshtëja e kompenzimit të antarëve të komiteteve të tjera është e rregulluar me ligjin horizontal nga ministria e financave dhe ministrive të tjera të linjës, por mundësitë buxhetore janë të kufizuara, dhe tash vetëm kemi një ndarje buxhetore sipas ligjit nuk jam për mos ndarje, më kënaqësi do ishte por veq e thash se tash kemi një ndarje buxhetore.

z. Shpejtim Gacafëri, vetëm për rendin e ditës kryesues, rendi i ditës votohet lillimisht dhe me pas pikat shtesë veq e veq, sepse po të vepronin kështu unë do isha kundër pikës së kërkuar nga z. Jetmir Tofaj do isha kundër.

1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z. Leonard Llojuni, kerkese nuk ka e hudhi në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar kush është për, për 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbalin e mbledhjes së kaluar u miratua.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për Hartimin e planit Lokal për Veprim në mjedis,

Sqarimin dhe arsyetimin e inicimit të proceduarve për Hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedisë e bëri z.Zenun Shala, UD i Drejtorisë për Kadaster dhe Urbanizim, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e sqaroi dhe arsyetoi inicimin e proceduarve për hartimin e planit lokal për veprim në mjedisë para anëtarëve të Kuvendit.

z.Leonard Llojuni, kerkese nuk ka, e qes në votim këte inicim kush është për, për 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se inicimi i hartimit të planit të veprimit në mjedisë u miratua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e "Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2033",

Sqarimin dhe arsyetimin e bëri z.Tafë Tofaj-UD i drejtorit për ekonomi dhe zhvillim, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe me pas e sqaroi dhe e arsyetoi para antarëve të Kuvendit, inicimin e procedurave për hartimin e "strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2026-2033"

z.Leonard Llojuni, kerkese nuk ka, e qes në votim inicimin e proceduarve për hartimin strategjik të zhvillimit ekonomik lokal 2026-2033, kush është për, për 14 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se inicimi i proceduarve për hartimin e procedurave të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2026-2033 u miratua.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Inicimit të procedurave për hartimin e Planeve Strategjike të Komunës së Junikut, të cilat janë në kompetencë të Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspektim, Mbrojtje dhe Shpëtim:

- Plan i Vlerësimit të Rrezikut,
- Plan për Reagim Emergjent,
- Plan i Transportit Publik dhe Mobilitetit,
- Plan për Mirëmbajtjen e Rrugëve dhe Hapësirave Publike,
- Plan për Mirëmbajtjen e Rrjetit të Ujësjellësit dhe Kanalizimit,
- Plan Komunal për Menaxhim të Mbeturinave,
- Plan Komunal për Menaxhimin dhe kontrollin e Qenve me dhe pa pronar.

Sqarimin dhe arsyetimin e bëri z.Demokrat Ganiqaj- UD i drejtori të Shërbimeve publike i cili pasi i përshëndeti të gjithë edhe një herë e sqaroi dhe e arsyetoi para antarëve të Kuvendit inicimin e procedurave për këto plane strategjike që janë në kuadër të kompetencave të drejtorisë për shërbime publike.

z.Leonard Llojuni, kerkese nuk ka une e qes në votim inicimin e proceduarve për hartimin e këtyre planeve në kuadër të drejtorisë për shërbime publike, kush është për, për 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se inicimit të procedurave për hartimin e Planeve Strategjike të Komunës së Junikut, të cilat janë në kompetencë të Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspektim, Mbrojtje dhe Shpëtim:

- Plan i Vlerësimit të Rrezikut,

- Plani për Reagim Emergjent,
 - Plani i Transportit Publik dhe Mobilitetit,
 - Plani për Mirëmbajtjen e Rrugëve dhe Tapësirave Publike,
 - Plani për Mirëmbajtjen e Rrjetit të Ujësjetës dhe Kanalizimit,
 - Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave,
 - Plani Komunal për Menaxhimin dhe kontrollin e Qenve me dhe pa pronar
- U miratua.

Para se të shkohet në pikën e pestë (5) të rendit të ditës që ishte në radhë z.Demokrat Ganijaj kërkoi që pikat e rendit të ditës që i përkasin drejtorisë për shërbime publike dhe drejtorisë së kadastrës dhe urbanizimit si shqyrtojnë tani pasi që këta dy drejtorë kishin takime, kjo kërkesë u miratua dhe për shqyrtim kaluan në pikën e tetë(8).

8. Shqyrtimi dhe miratimi i iniciimit të procedurës për ndryshim të Rregullores për taksë, ngarkesë dhe gjopa komunale,

z.Demokrat Ganijaj, nuk është kjo, ose është gabim teknik ose është teksti i gabur në emërtim të pikës pasi që në fjale është pika për rregulloren e mbeturinave.

z.Leonard Lolluni, zyrtari nga drejtoria e juaj ka bërë kërkesë në mbledhjen e KPF-se në këtë mënyrë, ekziston procesverbal, dhe nëse është vetëm iniciim në mund ta ndryshojmë emërtimin e pikës dhe e vazhdojmë.

z.Demokrat Ganijaj, jo nuk është iniciimi por jemi në procedurë e miratimit të leximit të parë ku me pas kalon në dëgjim publik dhe me pas vijë për miratim të plotë prap këtu në kuvend.

z.Leonard Lolluni atëherë nëse është në miratim të leximit të parë në nuk kemi material dhe mund ta lejmë për mbledhjen e radhës.

z.Shpejtim Gacaferi, nëse është me prioritet dhe urgjencë, kryesuesi mund të na thirrte në një jashtzakonshme, por nëse jo pa material nuk do ishte mirë që në të miratojmë diçka që nuk e shohim, jo për mua sepse nuk dyshoj në këtë por për hire të anëtarëve të tjerë.

z.Leonard Lolluni, meqë nuk kemi material unë konsideroj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës dhe të shqyrtohet në mbledhjen e radhës, e qes në votim kush është për, për 13 vota, kundër 1 votë dhe abstenim 0 vota, konstatoi se kjo pikë shtyhet për shqyrtim për mbledhjen e radhës.

9. Harmonizimi i vendimit me nr:002/05 date 02.02.2026 të listës së përgjishme të pronave në posedim të Komunes si dhe listës së veqante të planifikuara për dhënie në shfrytëzim,

Sqarimin dhe arsyetimin e harmonizimit të vendimit e bëri z.Zenun Shala-UD i drejtorit të drejtorisë për kadastrë dhe urbanizim, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve të kuvendit harmonizimin e vendimit me nr:002/05 të datës 02.02.2026.

z. Shpejtim Gacaferi, gjithëçka ka qene ne rregull, vetëm nëse dokumentacioni bashke me vendimin nuk ka shkuar, nëse e mbani ne mendë une e kam pyetur drejtorin se vite janë të parapara të ipen ne shfrytëzim, na ka dhan sqarimin, certifikata e pronesis ka qene, pastaj destinimi ka qene ne rregull, jo per çka ipen ne shfrytëzim sepse kjo nuk mundet te parashihet, investitorët bejen kerkese, dhe per kete une nuk e di, ndoshta ka shkuar mongu, nuk e kan bashkangjitur materialin ose nuk e ka permisuar drejtoria e urbanizmit.

z. Leonard Lolluni, sa per sqarim, ti ke katër vite sa ishe kryesues i kuvendit i ke dërguar kështu siq janë tani këto lista, dhe ka kaluar ligjshmërinë, une kame diskutuar me MAPI, ne, prezent ka qene edhe kryetari i komunës kur kame telefonuar me ta, dhe këto lista ju janë kthyer te gjithave komunave sepse qe na fillimi kto lista janë shkaur gabimisht, dhe ka mare vendim ministri qe këto lista mos te kalone me kështu, zyrtarja na ka njoftuar se si te coet tutje dhe jemi ktu ku jemi, dhe une e qes ne votim harmonizimin e vendimit, kush eshte per, per 14 vota, kundër 0 vota dhe abstënim 0 vota konstatoi se harmonizimi i vendimt me nr:002/05 dt.02.02.2026 u miratua.

5. Themelimi i Komisionit të kuvendit të Komunës për zgjedhjen e këshillit lokal, si dhe komisioni i ankesave lidhur me procesin e zgjedhjeve të këshillave Lokale

Sqarimin dhe arsyetimin e themelimit te keti komisioni e beri znj. Leonora Shehu- UD drejtorese ne drejtorinë administratës, e cila fillimisht i përshëndoti te gjithë te pranishmit dhe me pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anctareve te kuvendit, themelimin e komisionit te kuvendit komunale per zgjedhjen e këshillave lokale , si dhe komisioni e anekesave.

z. Jetmir Tofaj, faleminderi drejtoreshës per sqarimet e nevojshme, kjo eshte nje procedure standarte, qe e kerkeone edhe ligji, une vetëm kisha kërkuar nga drejtoria e administratese te jete me aktive ne aktevizimin e këtyre këshillave lokal, ato këshillat lokale te dalura nga zgjedhjet e kaluara nuk eshte se kane patur ndonjë rol, apo shërbim ndaje qyetareve, mbrenda komizës ligjore, mbrenda mundësive me pase me i aktivizuar pake me shume ato këshilla.

znj. Leonora Shehu, faleminderi per këshillën, siq e kam thesuar edhe ne mbledhjen e KPF, se, eshte hera e pare qe nga themelimi i komune se kemi themeluar këto këshilla lokale, per shkak te buxheti ndoshta edhe ka patur pake mospjesëmarrje apo mos aktivizim i kryetarve te këtyre këshillave.

z. Burim Kuçi, une e kam nje pervoje lidhur me kete qeshtje, sepse kame qene kryetar i këshilli lokal per lagjen Berishe, dhe ne te vertete nuk ka patur bashkëpunim te mire ndërmjet Komunes dhe kryetarve te këtyre këshillave, gjithemone eshte neglizhuar bashkëpunimi , andaj edhe kjo eshte ardhur si pasojë qe mos te jene te aktivizuar shume kryetarët e këtyre këshillave, shpresoj se ne te ardhmen te jete ky bashkëpunim me i madhe, duke e patur parashyshe se këto këshilla janë per te mirën e qytetarve.

znj. Leonora Shehu, nuk e di a ka qene mos bashkëpunimi i kryetarve te këshillave me komunën, apo e komunës me kryetar te këshillave, sepse ne gjithemon ju kemi dërguar ftesa per ndëgjim publik ose te propozimet per buxhetin dhe asnjë here nuk keni marre pjese, ose edhe takimet qe i kemi patur une si kordinatore qe isha ju kam dërguar ftes dhe shume rralle keni mare pjese,

kështu që ata që e marrin përgjesi të jenë kryetar të këtyre këshillave duhen edhe ta mbajnë atë përgjesi.

z.Burim Kuçi, është e vërtetë se duhet me marrë përgjesi, nga na ç'juaj, une si kryetar i këshillit nuk kam patur asnjë email zyrtar as vendim zyrtar që jame zgjedhur kryetar i këshillit, une mbas dy (2) viteve me ka ardhur njoftim se kami takim edhe atë sa me then formal.

znj.Leonora Shehu, une nuk ju kam dërguar email, por i kam të gjitha ftesat me protokoll që ju kam dërguar të gjithë kryetarve të këshillave, ndërsa sa i përket zgjedhjes tuaj si kryetar i këshillit lokal në si komision e punojmë në raport pas zgjedhjeve të këshillave lokal dhe ai raport është miratuar në kuvend me miratim të këtij raport nga kuvendi ju konsiderohi se jeni zgjedhur kryetar i këshillit.

z.Shpejtëm Gacaferi, vetëm një shpjegim për këta që nuk janë të njoftuar, çdo vendim që nxerret në kuvend për veç ministrit të arkivit janë të obliguar të njoftohen edhe palët, nuk është e vërtetë ajo që po e konstatojnë z.Burim Kuçi, është njoftuar secili kryetar i këshillave lokale e kanë marrë vendimet, a ka dashur me e pranuar jo ajo është diçka tjetër dhe të mos i kalojmë gjërat në spekulime kaq kisha.

Propozimet për komision të kuvendit për zgjedhjet e këshillave lokale:

LDK- propozon z.Sadri Krasniqi

AAK- propozon z.Burim Kuçi

L.VV-propozon znj.Elsa Himaj

Përbërja e komisionit të kuvendit për zgjedhjen e këshillave lokale është në këtë përbërje:

Kryesuesi i Kuvendit-z.Leonard Llojuni

Anëtar i nga LDK- z.Sadri Krasniqi

Anëtar i nga AAK-z.Burim Kuçi

Anëtarja nga L.VV-znj.Elsa Himaj

Kordinatorja znj.Leonora Shehu dhe

Një anëtare nga shoqëria civile

Propozimet për komision të ankesave:

LDK- propozon znj.Blerita Syla

AAK- propozon z.Alfred Gaxherri

L.VV- propozon z.Lulzim Gacaferi

z.Leonard Llojuni, i qes në votën përbërjen për të dy (2) komisionet në këtë përbërje të propozuara, kush është për, për 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota konstatoi se themelimi i komisionit të kuvendit të Komunës për zgjedhjen e këshillit lokal, si dhe komisioni i ankesave lidhur me procesin e zgjedhjeve të këshillave lokale u miratua.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut 2026-2030,

Sqarimin dhe arsyetimin e bëri z.Xhavit Velijaj- ud drejtorin e drejtorin e Arsimit, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit me pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve të kuvendit.

inicimin e procedurave per hartimin e planit zhvillimor te arsimit ne Komune e Junikut 2026-2030.

znj. Ajshe Gacaferi, pershendetje per te gjithë, me qene se jame mesimdhense me profesion dhe tani përfaqësuese e qytetarve ne kuvendin komunal, e ndjej per obligim te theksoj se ky plan nuk do te mbetet si dokument formal, andaj në kuadër të pikës së rendit të ditës për shqyrtimin dhe miratimin e inicimit të procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit 2026 – 2030 paraqes këtë propozim me qëllim që procesi i hartimit të planit të jetë gjithpërfshirës, profesional dhe i zbatueshëm në praktikë.

Çka konsideroj me rëndësi për grupin punues gjatë hartimit të këtij plani:

Të përfshihen mësimdhënës aktivë në grupin punues për hartimin e planit, në mënyrë që dokumenti të reflektoj realitetin e shkollës dhe sfidat konkrete të sistemit arsimor.

Të organizohen dëgjime publike me mësimdhënës prindër dhe nxënës ku rekomandimet e tyre të evidentohen me procesverbal dhe të reflektohen në draftin final.

Të përcaktohen objektiva të matshme me afate kohore të qarta, përgjegjësi institucionale dhe planifikim buxhetor.

Të përfshihet raportim vjetor në Kuvend Komunal mbi progresin e zbatimit të planit.

Ndërkaq me prioritet konsideroj që të ketë cilësi në mësimdhënie dhe trajnime praktike për mësimdhënës, mbështetja e nxënësve me vështirësi në të nxënë, digjitalizimi funksional i shkollave, përdorimi i tyre më saktë, ndërsa kush ka vështirësi në përdorim të trajnohen, si dhe mbështetja e talentave dhe nxënësve me intelegjencë të lartë.

Pra qëllimi ynë i përbashkët është që të hartojmë një plan realist, të zbatueshëm dhe me ndikim të drejtpërdrejt në cilësinë e arsimit në komunën tonë.

z.Xhavit Velijaj, sot eshte nje teme tjetër, eshte vetëm inicim i procedurave dhe do te kemi kohe qe ti dikutojme këto qeshtje qe u ngritën nga ane e znj. Ajshe Gacaferi.

z.Leonard J. Iolluni, kerkes tjetër nuk ka, e qes ne votim inicimin e procedurave per zhvillimin e arsimit, kush eshte per, per 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se inicimi i procedurave per hartimin e planit zhvillimor te arsimit ne komunën e Junikut 2026-2030 u miratua.

7. Themelimi i Komiteti për Arsim, Shkencë, Kultur, Rini dhe Sport

Sqarimin dhe arsyetimin e beri z.Jetmir Tofaj, parashtrues i kërkesës, i cili pasi i përshëndeti edhe një herë të gjithë të pranishmit, e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarve të kuvendit, themelimin e komitetit për arsim, shkencë, kultur, rini dhe sport.

z. Shpejtim Gacaferi, janë dy qeshtje, duhet me ditë, ose me lexuar, per me ditë duhet me lexuar, z.Jetmir Tofaj ma mbushi mendjen se ka lexuar, mirë por u ndjeva keq kur i lexoj nenet 14, na mashtroi nuk e tha realitetin, përbërja e këtij komiteti nuk eshte shumica nga kuvendi, por perbchet nga anetarët e kuvendit dhe duhen te jene ekspert, ne kuadër te kuvendit me përjashtim te znj. Ajshe Gacaferi nuk ka ekspert te kësaj fushe, dhe ne qofte se ngritët nje komitet i tille, mos eshte nenqimim per mesuedhensat kur te shkojmë ne si komitet me i vlersuar e ne nuk kemi lidhjes ne kete fushe, por edhe nëse mari anëtar per kete komitet si ekspert nga jashtë kuvendit, atëherë shohim se këta eksperta vetëm janë te kyqur ne arsim dhe kjo i bje konflikte interesi, por

edhe per kundër këtyre ne si kuvend edhe ne te kaluar kemi patur komitete tjera te ngitura, por ne munges te pagesave keto komitete nuk kane funksionuar.

z.Jetmir Tofaj, nuk e di se çka nuk thash te neni 14, u tha se nuk eshte shumica nga anetaret e kuvendit, këtu specifikohet qarte se ne komitete tjera qe formohen nga kuvendi per fushat e caktuara perbehen nga anetare e kuvendit dhe përfaqësuesit nga jashtë kuvendi, por shumica e anetarve perbehen nga anetaret e kuvendit, nëse numir maksimal i anetarve per nje komitet eshte pese (5) atëherë tre (3) janë nga kuvendi qe i bie shumica ndërsa sa i perket asaj se duhet te jene ekspert apo jo ky nuk eshte edhe kusht i domosdoshëm te jene eksperta, ne e kemi drejtorin e arsimit qe nuk eshte i asaj lamije dhe une nuk kam asnjë dyshim ne profesionalizmin e ti ne kryerjen e detyrave dhe te kompetenca qe i takojnë, pra eshte mire me qene ekspert por nuk eshte kushte i domosdoshëm me qene ekspert dhe mund te mos jene ekspert dhe te prodhojnë rezultat ne kete komitet, e kur thuani se duhet me qene eksperta , atëherë shiqone ekzekutivin drejtorin e arsimit nuk e kemi te asaj fushe.

z. Shpejtim Gacaferi, nuk e them une por e thotë udhëzimi administrativ 2020, ndërsa sa i perkte drejtori ai eshte post politik, dhe mjafton me qene menaxher i mire dhe nuk do me then me qene ekspres i arsimit dhe ne qofte se mendoni se duhet me qene ekspert i arsimit, une mendoje se eshte ekspert i arsimit sepse drejtori para gjashtembdhet (16) viteve kaqene puntor i arsimit ndoshta kete nuk e dini.

z.Jetmir Tofaj, eksperta ka edhe komuna e Junikut per kete komitet, por si do qofte une e shohë te rëndësishëm themelimin e ti, dhe nuk duhet te shihet si ofendim ndaj mesimdhensive, por si nje gje se eshte ka themelohet per tju ndimuar atyre si dhe institucioneve komunale, drejtoris se arsimit. Por ky komitet nuk eshte vetëm i kufizuar ne fushën e arsimit por do te kete shtrirje edhe ne fushën e shkencës, kulturës, rinis dhe sportit, fusha keto qe kërkojnë vëmendje te shtuar , per kete ka qene kerkese edhe e qytetarve drejtura ndaj meje andaj besoj se kam te drejte te propozoje themelimin e keti komiteti.

z. Shpejtim Gacaferi, do kishte qene me mire te deshtonete pika tjetër e propozuar sot po nga propozuati i kësaj pike, pike qe do ta shqyrtojmë sot, dhe kjo ma kujtona ate, se kuvendi nuk eshte me ate rrolin e kuvendi siq e kishte Kuvendi i Junikut para njeqinde sa viteve qe ka bere krenar Junikun ne te gjitha trevat Shqiptare, ndërsa sot po pretendohet qe Kuvendin e Junikut ta shendrojme ne asistence sociale. Por këto qeshte qe lidhen me arsimin ne ktu ne kuvend mund ti ngrisim sa here qe eshte e nevojshme nuk na ndal askush, përpos qe drejtori ka per obligim te raportoje dy here ne vite ne mund te ngrisim qeshje ne çdo seanc, andaj e shohë te pa arsishem themelimin e keti komiteti, dhe ne si grup i L.DK jemi kundër themelimit te keti komiteti.

z.Burim Kuçi, mua me habit fakti se si nuk ka patur komuna nje komitet te tille deri me tani, dhe ne si grupo jemi per themelimine keti komiteti, edhe per kundër asaj se sa jemi eksperta apo profesional mune te japim kontribut ku na kemi vullnet dhe deshire.

z.Xhavit Velijaj, une vetëm deshta te ndalem te emërtimi i pikës komiteti per arsim, shkence, kultur dhe deshta me pyet iniciuesin e keti komiteti se çka nënkupton me kete shkenc sepse nëse themelohet ky komitet do te ballafaqohem me kete.

z.Jetmir Tofaj, nënkupton aktivizimin e jetës brenda për brenda institucionit të arsimit, ndoshta për aktivizimin e garave në fushën e shkencës.

z.Xhavit Velijaj, në nuk jemi institut shkencore dhe nuk mëremi me hulumtime, andaj po e shohë se mos ja ke huqur në atë drejtim, sepse ka komitete të ngritur edhe neper komuna tjera dhe i ka shiquar dhe asnjë nuk ka të bëjë me shkencën, dhe kjo bjen me kundërshtim me detyra që kemi.

Propozimet për anëtar të komitetit për Arsim, shkencë, kulturë, rinë dhe sport:

L.DK nuk ka propozim

AAK propozon z.Aldi Gacaferi

LVV propozon znj.Elsa Hima

Edhe dy anëtar të jashtëm të propozuar nga ekzekutivi apo propozuesi i kësaj pike të sjellin mbrenda shtatë (7) ditëve.

z.Leonard Lolluni, unë e qes në votën themelimit të këtij komiteti në përbërje prej pesë (5) antarëve, kush është për, për 8 vota, kundër 6 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se themelimi i Komitetit për Arsim, shkencë kulturë, rinë dhe sport në përbërje prej pesë (5) anëtarëve u miratua.

8. Propozim për Lijim të Mjeteve Financiare për Kompenzimin e Anëtarëve të Komiteteve tjera të Komunës së Junikut

Sqarimin dhe arsyetimin e bëri z.Jetmir Tofaj, propozuesi i kësaj pike.

z.Shpejtim Gacaferi, sa kam qen kryesues shumë here kam kërkuar që të mos nxerrim vendime të kundërligjshme, që të mos dalim si kuvend joserioz, por ka ndodhur që të nxerrim këso vendime, dhe duke u nisur nga kjo, por kur tja shtojmë kësaj edhe atë që u çek gjatë prezentimit të kësaj pike se kjo nuk lejohet në baze të udhëzimeve administrative, atëherë unë nuk e di se çka të debatohet më tepër për këtë qeshtje.

z.Jetmir Tofaj, unë i tregova dispozitat ligjore për të cilat ministria nuk ben pagosa, por në të njëjtën kohë tregova edhe rrugën se si është e mundur me të kompenzuar, që janë miratuar nga kuvendet komunale, dhe që ministria jau ka kthejtë si të ligjshme, pra ekziston mundësi vetëm a ka vullnet për këtë qeshtje.

z.Leonard Lolluni, kerkese tjetër nuk ka, e qes në votim propozimin për lijin e mjeteve financiare, para se të votojmë konstatoi se në sallën e kuvendit prezent janë trembdhjetë (13) anëtarët e kuvendit, atëher kush është për, për 7 vota, kundër 6 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se propozimi për lijin e mjeteve financiare për kompenzimin e antarëve të komiteteve tjera të komunës së Junikut u miratua.

11. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit,

z.Jetmir Tofaj, edhe pse drejtori i shërbimeve publike nuk është këtu, pyetjen do tja bëjë kryetari të Komunës, a keni ndërmarr masa për sanimin e kanalizimit të ujërave të zeza afër Teqes së Sheh Xhaferit, unë kam pranuar shumë ankesa nga qytetarët e kësaj pjese andaj po e shtroi këtë pyetje.

z.Bedrush Hoxha, përshëndetje për të gjithë, ne si kompania " KRU Hidrodrin" kemi qene ne ate pjese dhe koleget e mi e kane shiquar dhe duhet te intervenohet, problem këtu eshte se kur ka te reshura te mdhja shtohet sasija e ujit dhe kapaciteti i gypit eshte i ulet, dhe kjo po e bene perzirjen e ujrave te zeza me ujrave te shiut, por per kundër kësaj ky problem do te sanohet.

z.Jetmir Tofaj, pyetje per kryetarin e komunës, hetimin per anëtar te kuvendit e kemi bere me dt.12.12.2025, dhe ende nuk e keni prezentuar ekzekutivin e ri, e di se keni mare disa vendime qe ti emëroni si ushtrus detyre, e pytja ime eshte se kur do te na prezentoin ekzekutivin e ri.

z.Ruzhdi Shchu, per shkak te angazhimeve qe kemi patur, shume shpejt do ti kemi emërimet per drejtor te drejtorive ne Komunen e Junikut.

z.Jetmir Tofaj, nëse ben edhe nje pyetje per kryetarin e Komunes, a keni ndermar diçka kundër pronave te uzurpuara, ne sot shqyrtoam listën e pergjishme te pronave dhe listën e veçante te pronave qe parashihen te ipen ne shfrytëzim, besoj e do ishte ne interes te komunës qe edhe këto prona qe janë te uzurpuara te lirohen dhe te hynë ne këto lista per shfrytëzime dhe do ishte me atraktive per investitorët.

Pergjigjeja do te ipet ne mbledhjen e radhës.

12. Te ndryshme,

z.Shpejtim Gacaferi, une edhe kur jua kame dorzuar detyrën ju kam premtuar se do te jem ne shërbim tuaj, jo se jame me i menqur. Por per shkak te përvojës, dhe po dua ti specifikoj dy gjera qe lidhen me punën e kuvendit, te pika pyetje per nga anctaret e kuvendit, secil anctare i kuvendit nuk ka te drejte te parashtoj me shume se dy pyetje, dhe qeshtja tjetër ka te beje me bisedat këtu nuk i flas me dy mendje, a kam gabuar a nuk kam gabuar, po ashtu kemi inxhizimin me kamer qe plasohet ne youtube dhe monitorohet edhe nga ministria e linjës, por eshte e ndaluar qe debatimet qe behen ne kuvendit te bisedohen jashtë kuvendit, po ashtu inxhizimet qofte te zerimit qofte me fotografi gjate seancës nga anctarete e kuvendit apo kush do qofte janë te ndaluara, mire do ishte qe këto dy gjera me i menaxhar ju si kryesues.

z.Leonard Lolluni, kete problem e kemi patur edhe gjate katër (4) viteve sa ju ishit kryesues, une si kryesues po dëshiroj te jemi me ju qe me ju dhen hapsire secilit sa me shume, permndyesh ne mund te shkojmë me rregullore e punës se kuvendit dhe aty janë te përcaktuara qe sa here lejohet te beje pyetje nje anëtar i kuvendit dhe sa here mund te merre tjalën per nje pike te caktuar re rendit te ditës.

z.Jetmir Tofaj, po nderlidhem me kete qeshtje, mbledhjet e kuvendit janë te hapura per publikun, kane te drejt edhe mediat te janë prezent ne mbledhje, me inxhizura dhe me e publiku, por ne te njëjtën kohe kemi kërkuar nga drejtorja e administratës ne mbledhjen e kaluar qe te respektohet rregullorja per transparencë dhe te publikohen ne rrjetët sociale ne platformën e komunës, ne platformën e kuvendit te komunës, atëherë per deri sa kjo qeshtje eshte e rregulluar me rregullore e punës se kuvendit nuk po e shohë si problematike, ndërsa sa i perketet rrespektimit te rregullore do ishte mire qe kjo te respektohet edhe nga ata sepse ktu patëm shume here replika, po ashtu nuk po e dim se ne cilin role janë , a ne ate te anëtar te kuvendit apo te zyrtarit ligjore.

z.Leonard Llojuni, sa i përket rregullores së punës së kuvendit në të thuhet në një nën, se diskutimet që bëhen në kuvend, që janë qeshje të ndishme, sekrete nuk duhet të bisedohen jashtë kuvendit, andaj dikush mund të thirret në këtë nën.

z.Bedrush Hoxha, unë e kisha pyetur z.Jetmir Tofaj, a keni leje për marrjen e burimit "atje" sepse në si KRU Hidrodrini gjatë verës kemi mungesë të ujit gjatë sezonit të verës që të furnizojmë të gjithë qytetarët e Komunes së Junikut.

z.Jetmir Tofaj, nuk e di kjo sa lidhet me rendin e ditës, me gjithë atë burim është në pronë private edhe të inkuaroj si zyrtar i ndërmarrjes publike që të marrësh të gjitha veprimet që të ke në kompetencë, por një kosit të inkuaroj të ngritësh zërin edhe për uzurpim të pronës publike.

z.Aldi Gacferi, përshëndetje për të gjithë qeshtja ka të bëjë në lagjen Gacfer të rrugës "Isa Tofaj" operatori ekonomik që është duke operuar në atë pjesë me saksisht në lumin Erenik a ka leje komunale, dhe kushte është përgjegjës për dëmet që janë duke u shkaktuar në rrugën "Isa Tofaj"

z.Ruzhdi Shehu, në atë pjesë është duke u bërë pastrimi i lumit Erenik, është me pëlqim të ministrit të ambientit, por dëmtimi i rrugës nuk lejohet dhe në do të marrim masat ndaj kësaj qeshtje.

z.Burim Kuçi, gjatë vërshimeve të fundit që patëm në Komunë të Junikut, në "Arasha" të shtëpia e Gjemajl Kuçi sa herë që ka vërshime atë pjesë e vërshojnë ujrat e zeza, dhe ky qytetar ka bërë kërkesë edhe në Komunë por edhe në kompaninë KRU "Hidrodrini" dhe nuk i keni ofruar zgjedhje.

z.Ruzhdi Shehu, kjo qeshtje është adresuar edhe më herët, dhe e ka vizituar edhe kompania KRU Hidrodrini dhe zyrtarët tanë, problemi ka qenë se kemi patur vërshime të mëdha dhe kapaciteti i gypave të kanalizimit të ujrave të zeza është i vogël, dhe besoj se kjo qeshtje është e monitoruar nga ana e KRU Hidrodrini.

z.Alfred Gaxherri, përshëndetje për të gjithë, qeshtja ka të bëjë me një ankese të banorëve në rrugën "Martirët e Junikut", në atë rrugë janë vendosur disa pengesa të shpejtesit të automjeteve, këto pengesa janë vendosur shumë afër njëra tjetër, në një distancë shumë të vogël kemi afër katër (4) pengesa të shpejtesit për automjetet, unë jamë që siguria e qytetarëve të jetë primare por këto po e pengojnë më të madhe qarkullimin e automjeteve si të vogla ashtu edhe automjetet të rëndë, kish qenë e mirë që projekti në atë rrugë të rishikohet edhe një herë dhe të vendosen më pak këto pengesa të shpejtesit dhe po ashtu të sinjalizohen sepse nuk janë të sinjalizuara.

z.Nj.Titafete Isufaj, përshëndetje për të gjithë, të njëjtin shqetësim e kam edhe në në Lagjen "Moronica" edhe aty kemi disa pengesa të shpejtesit të automjeteve po kanë probleme sidomos gjatë sezonit të dimrit, siq e dini rruga është rrugë përprjetës gjatë sezonit të dimrit për të kaluar këto pengesa duhet dishar të marrësh vullë për të kaluar, andaj unë kërkoj që ato pengesa të shpejtesit të automjeteve të hiqen, po ashtu në këtë rrugë afër Kulles është i vendosur një gyp dhe gjatë reshjeve të shiut ky gyp nuk ka kapacitet për kalimin e ujit dhe atëherë uji po kalon rrugës, edhe këtu do ishte mirë që të intervenohet me vedojen e gypave me kapacitet më të lartë.

dhe te evidentohet kalimi i ujit neper rruge sepse po behet i pa kalushme sidomos kemboret nuk mund te kalojn.

z.Ruzhdi Shehu, sa i perket pengesave te shpejtesis neper rruge, ne keto qeshtje i kemi shqyrtuar dhe do te permisohen, jane edhe kerkesa te qytetarve qe ne rrugën "Martiri e Junikut" te hiqen, po ashtu edhe per rrugën ne lagjen "Moronca" gjate vershimeve qe patëm komisioni per vlerësim te dëmeve ka dale ne teren dhe e ka vlersuar gjendjen aty, ate dokument e kemi dorzuar ne qeveri dhe pos sa te na kthehet vlersimi do te shiqojme mundësit te intervenohet, po ashtu ne do ti shiqojme edhe ato pengesa te shpejtësi ne ate rruge, por nje duhet ta keni parasysh se këto pengesa janë vendosur per sigurin e qytetarve.

z.Shpejtim Gacaferi, vetëm sa per rikujtim, une jame anëtar i Kuvendit si te gjithë ju i zgjedhur nga votat e qytetareve jo nga mundi i te tjerve si barts i listës, dhe po quditem se si mbrenda orës po harrojmë se çka po diskutojmë, kur te dal procesverbali do te shihet, sepse po aludohet tek ligjet dhe tek rregullorja e punës, qe une i diskutova ato janë per te mirën e te gjithë neve këtu ne kuvend andaj kur te dal procesverbali do te shini se me shume ka diskutuar z.Jetmir Tofaj per ligje se sa une dhe atëherë shihet se cili ishim anëtar i kuvendit apo zyrtar ligjor.

z.Jetmir Tofaj, une nuk jame me profesion jursit por as avokat nuk jame dhe gjithemone i referohem asaj se ktu mund te kote plotësim ndryshim, dhe arsya qe dola dhe dhe e sqarova para jush eshte se une isha propozues i atyre pikave dhe pe rate arsye i citova ato komente dhe ato ligje sepse ishin te nevojshme per e e bazuar propozimin tim.

z.Leonard Llollloni, une kam dy informata li ndaj me ju email adresat per secilin anëtar te kuvendit jan hapur i keni përpara, i keni udhëzimet se si te kyqi, dhe fjalëkalimin aktual mund ta ndërtoni menjëherë, informata e dyte eshte ne materialin qe jau kam dorzuar asociacioni i Komunave organizon trajnime per asamblist te ri, këto trajnime janë ne organizim me zyrën e OSBE_ se dhe kemi dy data qe ne si anëtar te kuvendit mundemi me mare pjese me dt.02.04.2026 ne Pejë ndërsa dita e dyte me dt.15.04.2026 ne Peje po ashtu, une konsideroj qe këto takime janë me rendesi te marim pjese dhe nje qeshtje tjetër lista e pagave psc nuk po na vije per nënshkrim.

z.Arton Krasniqi (Zyra e Personelit), përshëndetje per te gjithë, listën e pagave per Dhjetor 2025, Janar dhe Shkurt 2026 i kam pruar sot, ndërsa nje sqarim me dt.12.12.2025 kur eshte bere betimi i anëtarve te kuvendit ende nuk eshte realizura pagat per znj.Ajshë Gacaferi dhe znj.Berta Isufaj sepse pezullimin e punës qe e kane ber nga Arsimi, eshte arsye qe ende nuk kan kaluar ne listën e pagave te kuvendit, kjo vlene edhe per ty kryesues, dhe mua me ka ardhur nje shkrese nga thesari se ne majin Mars 2026 do te behet kompenzimi per ju te tre ne forme retroaktive.

z.Jetmir Tofaj, po nderlidhem edhe nje here me proceduart, konkretisht me rregulloren e transparencës, ju kisha ba lutje edhe nje here kush do qofte se eshte përgjegjës per kete qeshtje, administrata apo IT i Komunes, qe mbledhjet e kuvendit te trasmentohen edhe rrjetin social zyrtar te Komunes ne facebook, dhe te behet me vendim te kryetarit si punës shtese qe te përcillet me kamer anëtar i kuvendi i cili mer fjalën, ne menyre qe te jemi sa ma transparent para publikut, dhe qeshtja e dyte, ekziston rregullorja e punës se kuvendit, neni relevant per uljen e anëtarëve te kuvendit dhe aty specifikohet qe kryesuesi me shelat e grupeve te përfaqësuar ne

kuvend caktojne vendet e uljes per anetarët e kuvendit dhe ne si LVV kemi kemi dërguar ne forem te shkruar renditjen dhe po shohë se këtu paskan ndryshuar dhe kerkoj nga kryesuesi dhe nga administrata qe mos te bëjnë lëvizje me vendet e uljes se anetarve te kuvendit sepse kjo eshte e rregulloren e punës se kuvendit.

z.Leonard Lolluni, eshte e vërtet se vendi i uljes se anetareve te kuvendit eshte e rregulluar me rregulloren te punës se Kuvendit, andaj une kërkoj nga te gjithë shefat e subjekte politike qe janë te përfaqësuara ne kete kuvend te mi dërgojnë renditjen me shkrim dhe ne do ti vendosim edhe emrat ashtu sipas renditjes qe keni dërguar.

z.Shpejtim Gacaferi, eshte e veretete se kjo qeshtje eshte e rregulluar me rregulloren e punës se kuvendit, subjekti politik ne pushtet qëndron ne mesë, grypi i dyte ne kete rast AAK duhet sipas rregullore te jete ne te majtën time por qysh sote jemi te vendosur e kemi praktikuar edhe ne te kaluarën, ndërsa shefat e grupeve vendosn ne te majte ne fillim te rendit te pare te ulseve, per ndryshe kshu qysh jemi eshte ne rregull.

z.Leonard Lolluni, qeshtje tjetër nuk e shpalli te mbyllur mbledhjene dyte (2)

Procesmbajtësi:
z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Lolluni





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT
MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Referencë:	Numër: 002/1/03/26
Për/Za/To:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut
Nga/Od/From:	z. Leonard Lolluni - Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut
Datë/Datum/Date:	11.03.2026
Tema/Subjektat/Subject:	RAPORT PUNE



Vendi: Komuna e Junikut
Hartuesi: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut
Lloji i punës: Raport pune

**“RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
JUNIKUT PËR VITIN 2025”**

Junik, Mars 2026

Kuvendi i Komunës së Junikut në përputhje me obligimet që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës së Junikut, Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe ligjet e tjera në Republikën e Kosovës, për vitin 2025 harton këtë:

RAPORT PUNE

Kuvendi i Komunës së Junikut është organi më i lartë i themeluar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (neni 35).

Kjo është legjislatura e gjashtë e këtij organi e dalë nga zgjedhjet lokale 2021.

Kuvendi i Komunës së Junikut numëron gjithsejtë 15 anëtarë prej të cilëve 8 janë meshkuj dhe 7 femra. Në kuvend janë të përfaqësuar tri subjekte politike: LDK me 6 këshilltarë, AAK me 6 këshilltarë dhe LVV me 3 këshilltarë.

Përveç Kuvendit si organ ligjvënës në kuadër të tij janë të themeluara edhe trupa ndihmës siç janë komitetet dhe komisionet. Deri më tash janë të themeluara dy komitete (dy të përhershme Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete), Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, 2 komisione (themelimi i Panelit Përzgjedhës të Anëtarëve të komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara , formimi i komisionit për vlersimin e situatës së ish deponisë së materialeve inerte).

Mirëpo për të gjitha çështjet tjera siç janë dërgimi i materialit, arkivimi si dhe evidentimi protokollar i të gjithë materialit të kuvendit është punuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ldhëzimin Administrativ MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregullorën e Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut duke respektuar atë që ka qënë e mundur Planin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2025.

TRAJNIMET DHE PUNTORITË

Gjatë vitit 2025 antaret e Kuvendit Komunal kanë pasur shumë takime njoftuese / trajnime/ që lidhen me punën e Kuvendit të cilat kanë qënë të pergaditura nga Ministrinë dhe Organizatat e ndryshme me qëllimin që anëtarët e Kuvendit të jenë sa më të njoftuar për punën në Kuvend.

Po ashtu ka pasur disa takime të organizuara nga Asociacioni i Komunave të Kosoves ku Kuvendi Komunal i Junikut ka qënë i përfaqësuar nga Antaret (2) të Zgjedhur nga ana e Kuvendit dhe nga Kryesuesi i KK Junik.

Gjatë vitit 2025 Kuvendi i Komunës së Junikut ka mbajtur gjithsejtë 9 mbledhje të rregullta dhe tri (3) mbledhje solemne (17 Shkurti Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, 13 Qershtori dita e Çlirimit të Junikut dhe 5 Marsi Epopeja e Ushtrisë çlirimtare të Kosovës) derisa mbledhje të jashtëzakonshme janë mbajtur tri (3) sepse është paraqitur nevoja.

Pothuajse në të gjitha mbledhjet ka mbivotëruar fryma e arsyes dhe janë trajtuar çështje të rëndësishme për komunën e Junikut.

Komitetet e përhershme Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë vitit 2025 kanë mbajtur gjithsejtë 9 mbledhje të rregullta sipas planeve të miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut, Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsejtë 9 mbledhje të rregullta, kurse Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur gjithsejtë 6 mbledhje të rregullta.

Puna e komisioneve të ngritura nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut do të pasqyrohet në raportin e punës së secilit komision veç e veç.

RREGULLORET;

Kuvendi i Komunës së Junikut për vitin 2025 ka miratuar gjithsejtë 2 rregullore (plotësim - ndryshime).

1. Rregulloret e miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut në vitin 2022 janë:
 - 1.1. Rregullorja për Transparencë 2024-2028 (plotësim ndryshim), (vendimi i KKJ numër 02/05/25 i datës 31.01.2025);
 - 1.2. Rregullorja (plotësim - ndryshim) për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2026 (vendimi i KKJ 02/19/25 i datës 31.07.2025); dhe

Përveç kësaj gjatë vitit 2025 Kuvendi i Komunës së Junikut ka nxjerrë gjithsejtë 29 akte prej të cilave të gjitha janë vendime. Nuk ka nxjerrë asnjë rekomandim dhe asnjë njoftim për arsyec se për të njëjtat nuk është bërë asnjë kërkesë.

Në vijim në mënyrë tabelore po paraqesim aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2025.

AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2025

Nr.	Emërtimi	Numri i vendimit	Data e vendimit	Data e miratimit	Vërejtje
01	Vendimi për përmirësimin e vendimit nr.02/24/2024 i datës 26.11.2024 mbi caktimin e normave tatimore për taksim në pronën e paluajtshme për vitin 2025.	02/01/2025	31.01.2025		
02	Vendim për miratimin e Raportit të punës së KKS-së të Komunës së Junikut për vitin 2024.	02/02/2025	31.01.2025		
03	Vendimi për miratimin e Raportit të punës së Kuvendit Komunal të Junikut për vitin 2024.	02/03/2025	31.01.2025		
04	Vendim për miratimin e Planit të punës së Kështjullit Komunal për Siguri në Bashkësi/KKSB/të Komunës së Junikut për vitin 2025.	02/04/2025	31.01.2025		
05	Vendimi për ndryshim plotësim të vendimit Nr.02/33/24 i datës 30.12.2024 Rregullorja për transparencë 2024-2028 dhe Planit i Veprimit të Komunës së Junikut.	02/05/2025	31.01.2025		
06	Vendimi për miratimin e planit të punës për të drejtat e fëmijëve.	02/06/2025	31.01.2025		
07	Vendimi për miratimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete të Komunës së Junikut për vitin 2025.	02/07/2025	31.01.2025		
08	Vendimi për miratimin e Raportit të punës së Komitetit për Komunitete të Komunës së Junikut për vitin 2024.	02/08/2025	28.02.2025		

Adresa:
Tel.: +385 (0) 49 760 282

[/rks-gov.net/junik](http://rks-gov.net/junik)

09	Vendimi për bartjen e të hyrave votanake të pashpenzuara në vitin 2024 për shpenzim në vitin 2025.	02/09/2025	28.03.2025		
10	Vendimi për miratimin e Planit Lokal për barazi gjinore 2025-2027 dhe Planit i veprimt.	02/10/2025	28.03.2025		
11	Vendimi për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033.	02/11/2025	30.04.2025		
12	Vendimi për fillimin e hartimit (projekt) Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksat, ngarkesa dhe gjoha Komunale.	02/12/2025	31.05.2025		
13	Vendimi për hapjen e diskutimit publik për projekt Planin Komunal të veprimt për Energji dhe Klimë 2025-2028 për Komunën e Junikut.	02/13/2025	30.05.2025		
14	Vendimi për miratimin e projekt Planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Komunën e Junikut,(Leximi parë).	02/14/2025	30.05.2025		
15	Vendimi për miratimin e Kornizës afatnesme buxhetore komunale 2026/2028.	02/15/2025	27.06.2025		
16	Vendimi për zgjerimin e zones urbane në Komunën e Junikut.	02/16/2025	27.06.2025		
17	Vendimi për hapjen e diskutimit publik për projekt Rregulloren për taksat, ngarkesa dhe gjoha Komunale për vitin 2025.	02/17/2025	27.06.2025		
18	Vendimi për miratimin e raportit të vlerësimeve të dëmeve të shkaktuara nga temperaturat e ulëta dhe reshjet e dëbores në Komunën e Junikut, të datës: 06,07,08 dhe 09 Prill të vitit 2025.	02/18/2025	27.06.2025		

19	Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha Komunale për vitin 2026.	02/19/2025	30.11.2025		
20	Vendimi për miratimin e themelimit të institucionit parashkollorë publik në Komunën e Junikut.	02/20/2025	31.07.2025		
21	Vendimi për miratimin e dy anëtarëve të Komisionit përzgjedhës për pozitën, drejtor të institucionit parashkollorë.	02/21/2025	31.07.2025		
22	Vendimi për miratimin e Planit Komunal për trashëgimi Kulturore 2025-2030.	02/22/2025	31.07.2025		
23	Vendimi për miratimin e Planit Komunal të veprimit për energji dhe klimë (PVVEK) 2025-2028.	02/23/2025	31.07.2025		
24	Vendimi për miratimin e kërkesës për faljen e borgjeve dhe lirimin nga taksa komunale për ushtrim të veprimtarisë.	02/24/2025	31.07.2025		
25	Vendimi për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut me numër 02/16/2025 dhe numër të protokollit 2-180-4898 (për zgjerimin e zonës urbane në Komunën e Junikut).	02/25/2025	29.08.2025		
26	Vendimi për miratimin e Planit ndër-komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Komunën e Junikut.	02/26/2025	29.08.2025		
27	Deklaratë - Kuvendi i Komunës së Junikut përkrah dhe mbështet idenë, respektivisht kërkesën e Grave deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës për "Deklaratën për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj Grave në politikë dhe	02/27/2025	29.08.2025		

	jetën publike në nivel lokal.				
28	Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2026.	02/28/2025	11.12.2025		
29	Vendimi për miratimin e Planit-nder-komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Komunën e Junikut, sipas rekomandimeve të ministrisë së lartjes.	02/29/2025	11.12.2025		

Përfundim:

Në këtë raport pune janë pasqyruar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut, por kurrsesi nuk mund ta konsiderojmë si të plotë, pasi që nuk kanë mundur të pasqyrohen edhe aktivitetet e trupave ndihmës të Kuvendit të Komunës së Junikut për shkak të mungesës së raporteve të punës së tyre për vitin 2025 të cilat pas hartimit duhet t'i prezantohen Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

Përfundimisht Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2025 ka funksionuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut duke u ballafaquar me probleme si të natyrës teknike (logjistike) ashtu edhe të natyrës ligjore dhe bashkëpunimit me ekzekutivin sa u përket respektimit të procedurave ligjore lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike komunale.

Me këtë rast në emër të Kuvendit të Komunës së Junikut, ju falënderoj të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Junikut për kontributin e dhënë deri më tash.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Leonard Llojani

